01-845

PRISHTINA

# Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

## Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në pajtim me nenin 3,13,14,55 të Ligjit 02/L-28 dt. 22.07.2005 për Procedurën Administrative; nenit 2 al.1 pika 2, nenit 29,33,34 dispozitave të nenit 39,48,49, 51 dhe 60 të Ligjit për Ndërtim nr. 2004/15 dt. 27.05.2004; nenit 16 al.1 shkronja "c" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455 dt. 31.03.2008; nenit 17 al.1 shkronja "d" të Ligjit nr.03/L-040 për Vetqeverisje Lokale i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 28 dt. 04.06.2008; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas kërkesës 05-nr.351-13171, dt.18.05.2009 të parashtruar nga **Adem Luta,Hamide Miftari dhe Hatixhe Uka** dhe investitorit Sh.P.K."Pozhegu Brathers" nga Fushë Kosova , për lëshimin e lejes ndërtimore në lagjën ,,Mati1", merr:

## AKTVENDI

I. **I LEJOHET Adem Luta,Hamide Miftari dhe Hatixhe Uka** nga Prishtina dhe investitorit **Sh.P.K."Pozhegu Brathers"** nga Fushë Kosova, ndërtimi e objektit shumëbanesor , në Lagja "Mati1", në ngastrën kadastrale nr.740/21 e evidentuar në fletën poseduese nr.607, Komuna Kadastrale Prishtinë, me sipërfaqja 900m²,dhe etazhiteti **B+ P+5** me sip.(**2310**m²).

II. Hartimin e projektit për objektit kolektiv banimor nga pika I e këtij aktvendimi e ka bërë.N.P."A2" nga Prishtina me nr.të biznesit 70430062 dhe Vendimin pë dhënjen e licencës dhe klasifikimin e kategorive të licencës për këtë ndërmarje menr.0863 të dt. 31.07.2007. nga Prishtina dhe revidimin .e ka bërë N.P.N.I**"A&Ceng" ,nga Gjakova** me nr.të biznesit 70169511dhe Vendimin pë dhënjen e licencës dhe klasifikimin e kategorive të licencës për këtë ndërmarje menr.0305 të dt. 30.03.2006.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është edhe dokumentacioni teknik që është marrë si bazë për lejimin e ndërtimit të objektit shumëbanesor nga pika I e këtij Aktvendimi.

IV. **Investuesi është i obliguar**:

- Të lejohen inspektorët të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes të ndërtimit të objektit për të cilën është dhënë leje ndërtimi se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së nërtimit dhe kushteve urbanistiko- teknike të caktuara.
- Që të ruajë një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit, është dhënë kjo leje ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorije, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Që të sigurojë shënimin e ngastrës ndërtimore, vijës së regulacionit, nivelizimit dhe vijës ndërtimore nga Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë;
- Ta lajmëroj kësaj Drejtorie për ditën e fillimit të punës, së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit;
- Që pas kryerjes së themeleve ta lajmëroj këtë organ, në mënyrë që të bëhet kontrollimi I ndërtimit të themeleve dhe konstatimi se ato janë ndërtuar në harmoni me kushtet urbanistiko-teknike, projektin dhe për këtë të mirret vërtetimi me shkrim;
- Që pas kryerjes së objektit , e më së voni në afatin prej 8 ditësh ta paraqes kërkesën për kontrollimin teknik të objektit të përfunduar në mënyrë që të paiset me leje për përdorim.

V.Leja e ndërtimit pushon së vlejturit nëse punët ndërtimore për të cilat leja e ndërtimit është dhënë, nuk fillojnë në afatin prej dy vitesh nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit,apo nëse punët reth ndërtimit ndërpriten për periudhë prej 2(dy ) vite kur skadon leja e ndërtimit për ndërtim parcial.
**Leja e ndërtimit mund të zgjatet me paraqitjen e një kërkese për zgjatje , për një vit me të drejtë përsëritje.**

### A r s y e t i m

Pronaret **Adem Luta,Hamide Miftari dhe Hatixhe Uka** nga Prishtina dhe investitorit **Sh.P.K."Pozhegu Brathers"** nga Fushë Kosova me kërkesën nr.05-351-13171 të dt. 18.05.2009 i është drejtuar kësaj Drejtorie për lejimin e ndërtimit të objektit shumëbanesor të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

**Bashkangjitur me kërkesë investitori ka paraqitur këtë dokumentacion**:

- Lejen urbanistike nr.05-350-17114/1 dt.12.01.2009. të lëshuar nga ky Drejtorat
- Konkluzion –Paraprojekti me nr.05/350-17114/1 të dat.12.01.2009
- Konkluzioni –zgjidhja e projektit ideor me nr.05/350-17114/2 të dat.18.02.2009
- Projektin kryesor në 3 kopje,
- Provën mbi të drejtën e pronësisë apo të shfrytëzimit të ngastrës kadastrale nr. 740/22 të evidentuar në fletën poseduese nr.607KK Prishtinë të lëshuar nga kjo Drejtorati ,
- Aktvendimin mbi kompenzimin e rregullimit të tokës ndërtimore,
- Pëlqimi për rregullimin e dokumentacionit teknik nga KEK-u, nr.1758 dhe datë 22.04.2009,
- Dhënja e kushteve teknike për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit nga Ujësjellësi rajonal "Prishtina", nr.298/1 dhe datë 18.03.2009.
- Dhënja e Pëlqimi për gropimin PTK nga Telekomi i Kosovës ,nr.03/929/09 dhe dat.11.03.2009
- Vërtetimet nga Drejtoria për Financa dhe Pronë, KK Prishtinë, me nr.04/435-12879 të dat.18.05.2009 .
- Kontrata për ndërtim të përbashkët e vërtetuar në Gjykatën Komunale VR.nr.10887/2008 dt. 30.12.2008,
- Elaboratin Gjeomekanik është punuar nga N.K.Gj. "Geomerkur" me nr.të biznesit nr.80131607 dhe licencë kualifikimi nr.597 dt. 21.07.2006 në Prishtinë
- Pëlqimin nga Drejtorati i Sh.P.dhe EC- 07nr.80-13840 dt. 27.05.2009.

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të prezentuar ka vërtetuar se, investotri ka prezentuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativën ligjore nga lëmia e ndërtimit dhe se, i njejti është në harmoni me kushtet urbanistiko-teknike dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

- **Udhëzimi juridik**: Pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t´i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorzim të këtij vendimi
- **I dërgohet**: Investitorit, sektorit të inspekcionit tëndërtimit, sektorit për Kadaster dhe gjeodezi, Drejtorisë për ekonomi dhe Financa,Drejtorisë për prone, në lëndë dhe zyrës pritëse

**DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**
**I KOMUNËS SË PRISHTINËS 05 nr. 351-13171 të dt. 27.05.2009**

| Punoi: | UD.Shef Sektori : | DREJTORI |
|---|---|---|
| Ark.Hasnie Beqiraj inxh.dip. | ark. Nazmije Tora, inxh.dipl. | Shiqeri Spahiu, ing.dipl. |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E PRISHTINËS * DREJTORIA E URBANIZMIT

PRISHTINA

KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË * MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

# KOPJE PLANI / KOPIJA PLANA

## DREJTORATI PËR KADASTËR DHE GJEODEZI

Shk.e zvog./ Razmera 1: 2500

Komuna kadastrale /Katastarska opstina : MATIČAN

Fletëposedimi nr. / Posedovni list br. 607 Plani nr./ Br.plana 4 Skica nr./ Br.skice

Pronari,Shfrytëzuesi /Vlasnik,Korisnik : 1/3 HAMIDE MIFTARI /SADIK/
1/3 ADEM LUTA /SADIK/
1/3 HATIXHE UKA /SADIK




Nr.rendor i taksave / Redni broj takse 6059/08

| Nr.i ngastrës Br.parcele | Kultura | Klasa | Troll-vendi i quajtur Potes-zvano mesto | Sipërf. Povr. ha | a | M2 | Të ardhur.kad. Katast.prihod |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 740/21 | Bujrsen | | NTELMESINA | | 9 | 00 | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

Çë kjo kopje është identike me kopjen e origjinalit të vitit ____ apo gjendja faktike e vitit ____
Da ova kopija je identicna sa kopjom originala godine ____ ili fakticko stanje godine ____

Prishtinë / Prishtina 15. 01 2008 v./g. E punoi:/ Uradio-la: ____

Drejtori /Direktor
Sabedin HAXHIU






Bodrumi
siperfaqe bruto A=528 m2
lartesia e katit H=288 cm




Perdhesa, Kati 1, 2, 3, 4
siperfaqe bruto A=389 m2
lartesia e katit H=288 cm




Kati 5
siperfaqe bruto A=230 m2
lartesia e katit H=288 cm